

Korça

Shqipëri–Albania

Profili i Biznesit 2006

Mundësi të reja në një qytet me histori



Business Profile 2006

New opportunities in an historic city



Bashkia Korçë
Korça Municipality





● Përmbajtja

Parathënie.....	2
Gjeografia.....	4
Transporti dhe Komunikimi.....	6
Ekonomia.....	8
Turizmi	10
Biznes.....	12
Shërbimet Publike.....	14
Taksat dhe Tarifat.....	16
Kultura.....	18
Cilësia e Jetës.....	20
Financimi	22

● Contents

Foreword.....	2
Geography	5
Transport and Communications	7
Economy.....	9
Tourism	11
Business	13
Public Services and Utilities	15
Taxes and Tariffs.....	17
Culture	19
Quality of Life	21
Funding	23

Është tashmë koha më e mirë prej qindra vjetësh për të nisur një biznes në Korçën. Qyteti ofron një mjedis tërheqës në të cilin mund të punohet e jetohet, dhe tashmë me një tregti në zhvillim me vendet fqinje, ekonomia po rritet më shpejt se asnjëherë më parë. Korça ka qenë për një kohë të gjatë një qytet tregtar i rëndësishëm në Ballkan dhe përtëritja ekonomike po mundëson forcimin e pozicionin e saj si qendër kulture, biznesi dhe fetare.

Bashkia e Korçës ka hartuar Strategjinë e vet për Zhvillimin Ekonomik për periudhën 2005–2010, që synon ta çojë përpara zhvillimin ekonomik dhe të përtërijë bizneset vendase. Kjo strategji është përqendruar në bashkëpunimin e ngushtë mes bashkisë dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM), të konsideruara si elementët kryesorë të zhvillimit ekonomik vendor. Konceptet dhe metodologjia e zhvillimit ekonomik vendor bazohen në krijimin e kushteve për zhvillimin dhe nxitjen e bizneseve ekzistuese, për hapjen e bizneseve të reja, si edhe për tërheqjen dhe angazhimin si të investuesve vendas dhe të huaj.

Strategjia paraqet vizionin e bashkisë për zhvillimin ekonomik të Korçës për pesë vitet e ardhshme, deri më 2010.



VIZIONI

Korça do të jetë një qendër e rëndësishme urbane dhe universitare që përkrah zhvillim ekonomik vendor dhe rajonal duke i dhënë hov zhvillimit të infrastrukturës së vet nëpërmjet bashkëpunimit institucional me qytetarët dhe komunitetin e biznesit, duke ndërtuar mbi potencialin e vet, si edhe duke mbështetur traditat e veta kulturore dhe historike

Objektivi final strategjisë sonë është, të krijohen kushte më të mira për njerëzit që punojnë dhe jetojnë në Korçë, të shërbejë si përgjigje për të tërhequr biznese të rinj e që të zgjedhin qytetin tonë për t'u vendosur e të forcojë partneritetet mes qeverisë bashkiake dhe sektorit privat në funksion të zhvillimit ekonomik të qytetit.

Profili i Biznesit, i paraqitur në vijim, është dokumenti i parë i këtij lloji i përgatitur nga Bashkia në funksion të zbatimit të strategjisë. Ai përbën një instrument të sintetizuar marketimi për potencialet natyrore, historike, ekonomike dhe biznesit të Korçës.

Ky profil synon t'i ofrojë komunitetit të biznesit dhe të gjithë atyre që kanë interes për të bashkëpunuar një fotografim të faktorëve zhvillues dhe të mundësive investuese që ofron Bashkia Korçë dhe zona përreth saj. Informacionet dhe të dhënat e përfshira në këtë dokument do të jenë objekt përditësimi, strukturimi dhe detajimi të mëtejshëm në varësi të nevojave dhe zhvillimeve ekonomike të zonës.

ROBERT DAMO
Kryetari i Bashkisë së Korçës

Foreword

Not for several hundred years has there been a better time to set up a business in Korça. The city offers an attractive environment in which to work and live, and now with increasing trade with our neighbouring countries the economy is growing fast. Korça has for centuries been an important market town in the Balkans and its economic revitalization is reinforcing its position as a cultural, business and religious centre.

The Municipality of Korça has drawn up its Economic Development Strategy for the period 2005-2010, aiming at driving forward economic development and invigorating local business. This strategy is centred on the existence of close collaboration between the municipality and small and medium enterprises (SMEs), seen as the main elements of local economical development. The concepts and the methodology of local economical development are focused on establishing the conditions for developing and stimulating existing businesses, creating new businesses and attracting and engaging both national and international investors.

The strategy gives the municipality's vision of the economical development of Korça for the next four years, until 2010.

The final objective of our strategy is the creation of better conditions for the people who work and live in Korça, so that this in turn will feed back into attracting new businesses to choose our city as the place to come. This will strengthen the partnerships that exist between municipal government and the private sector to the benefit of the economic development of the city.

The present Business Profile is the first such document to be prepared by the Municipality to help the strategic plan implementation and as such is a tool to be used for marketing the natural, historical, economic and business potential of Korça.



VISION

Korça will be an important urban and university centre that promotes local and regional economic development by developing its infrastructure through institutional cooperation with its citizens and the business community, and by building on its potential, as well as by supporting its cultural and historical traditions

This profile presents to the business community and all others that might be interested the development factors and investment possibilities available in the Municipality and its surrounds. The information and data contained in this document act as a reference point for the needs and future economic development of the area, and will be continuously updated.

ROBERT DAMO
Mayor of Korça

Vendndodhja

Qyteti i Korçës ndodhet në juglindje të Shqipërisë, në qarkun që mban të njëjtin emër e kufizohet me dy shtete të tjera Greqinë dhe Maqedoninë. Korça është ndër qytetet e pozicionuara në mënyrën më strategjike dhe më të mëdhenj të vendit dhe është gjithashtu qendër e Qarkut të Korçës brenda të cilit ndodhen edhe bashkia e Pogradecit, Bilishtit dhe Ersekës.

Bashkia e Korçës shtrihet në një lartësi mesatare 873 m mbi nivelin e detit. Qyteti shtrihet në fushëgropën në rrëzë të Malit të Moravës. Pjerrësia natyrore e qytetit është e radhë edhe mes qyteteve të Ballkanit.

Demografia


Qyteti i Korçës ka një rritje të qëndrueshme të popullsisë që demonstroi potencialin e tij zhvillues dhe forcimin e rolit si qendër ekonomike.

Viti	Banorë
1879	13.000
1923	25.598
2005	85.000 ¹
<i>Rritja e popullsisë</i>	<i>0,5% për vit</i>
<i>Densiteti i popullsisë</i>	<i>54 banorë/ha</i>
<i>Qarku i Korçës</i>	<i>360.000² banorë</i>
<i>Republika e Shqipërisë</i>	<i>3.100.000² banorë</i>

1, Zyra e Statistikave në Bashki, 2006; 2, Raporti mbi Zhvillimin Njerëzor i KB 2006, bazuar në të dhënat nga 2004

Burimet Natyrore

Pranë Korçës rrjedh lumi i Devollit, që buron nga mbrapa dhe në jug të maleve të Moravës të cilët ndodhen në lindje të qytetit. Pranë Korçës ndodhet tre liqene, ai i Ohrit, Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël, secili me karakteristikat e veta dhe secili ndër më të vjetrit në planet. Në perëndim të Korçës shtrihet rrafshnalta e



Voskopojës, me majën më të lartë të qarkut malin Ostrovica 2.383 m të lartë. Në jug dhe veri shtrihet një tokë e pasur bujqësore me një sipërfaqe prej 200 km². Për shkak të klimës kontinentale (temperatura më e ulët mesatare -3°C dhe më e larta mesatare 26,8°C, si edhe më shumë se 250 ditë me diell dhe 790 mm reshje në vit), prodhimtaria e zonës është shumë e lartë.

Në malet përreth qytetit ka shumë burime minerale që përfshijnë qymyr, hekur, nikel dhe talk (silikat magnezi), që në të kaluarën kanë kontribuar në zhvillimin industrial të qytetit. Pasuria e zonës në burime natyrore, gurë, pyje, faunën dhe florën e rrallë, krijojnë një potencial të madh për zhvillimin e industrisë së turizmit e për rrjedhojë për zhvillimin ekonomik të qytetit të Korçës.

Geography



© Google

Location

The city of Korça is located in south-east Albania, in the Region that bears the same name and which shares borders with two other countries, Greece and Macedonia. Its location and the fact that the city is the centre of the Korça Region, which includes the municipalities of Pogradec, Bilisht and Ersekë, makes Korça one of the most strategically located cities in the country.

Korça is located on a plateau at an average altitude above sea level of 873 m at the foot of Morava Mountain, which provides the city a steady natural incline, rare among Balkan cities.

Demography

Korça city is undergoing sustainable population growth, demonstrating its development potential and strengthening its role as an economic centre.

Year	No. of inhabitants
1879	13,000
1923	25,598
2005	85,000 ¹
Growth	0.5% per annum
Density	54 inhabitants per ha
Region	360,000 ¹ inhabitants
Country	3,100,000 ² inhabitants

1, Municipal Statistics Office, 2006; 2, UN Human Development Report 2006, based on data from 2004

Natural Resources

There is a major river (Devoll) that flows near to Korça with its source behind and south of Morava Mountain immediately to the east of the city. There are also three lakes (Ohrid, Prespa and Little Prespa) near Korça, each with its own characteristics and each among the oldest on the planet.

To the west of Korça lies the Voskopoja highland, with the highest peak in the region, Ostrovia Mountain, at 2,383 m. To the south and north lies rich agricultural land with an area of about 200 km². With the region's continental climate (average low of -3°C and average high of 26.8°C and more than 250 sunny days a year and 790 mm precipitation), the productivity of the area is very high.

In the mountains close to the city there are many mineral resources, including coal, iron, nickel and talc (magnesium silicate), which, in the past, contributed to the industrial development of the city. The region's wealth in other natural resources, stone, forests, rare fauna and flora, creates huge potential for the development of the tourism industry and thus Korça's economic development.

Transporti dhe komunikimi

Vendndodhja e Korçës mundëson mbërritjen në katër aeroporte ndërkombëtare dhe dy porte detare në më pak se katër orë me makinë.

Largësia nga qytetet e tjera të Ballkanit

Qyteti	Distanca (km)
Tirana (aeroporti)	180
Durrës (porti)	200
Selaniku (porti & aeroporti)	250
Shkodra	268
Shkupi (aeroporti)	287
Prishtina (aeroporti)	310

Rrugët

Qyteti i Korçës dallohet për infrastrukturë të veçantë. Rrugët ruajnë karakteristikat e vjetra me bulevarde të gjëra dhe të asfaltuara dhe me trotuare me bordura guri të gdhendura. Lagjet e Ansamblit Tradicional, të cilat mirëmbahen mirë, janë të shtruara me kalldrëm me gurë të zinj nga Mali i Moravës, duke i dhënë qytetit një pamje krejt të veçantë në krahasim me shumë qytete kryesore të Shqipërisë. Gjatë dekadës së fundit bashkia filloi të rigjallërojë qytetin e Korçës. Më 2006, bashkia synon sistemimin dhe asfaltimin e rreth 20.000 m² rrugë dhe 8.000 m² trotuare.

Krahasuar me zonat e tjera të Shqipërisë, Korça ka një rrjet rrugor me cilësi të mirë. Përveç kësaj, janë bërë investime për të përmirësuar rrugët që lidhin Korçën me pjesën perëndimore të vendit, me kryeqytetin Tirana dhe qytetin portual detar të Durrësit, përgjatë Korridorit Ndërkombëtar VIII, i cili lidh portin e Detit të Zi, Burgas, me detin Adriatik.

Transporti

Transporti me autobus për në qytetet dhe qytezat e tjera të Shqipërisë ofrohet nga kompani private dhe kryesisht për qytetet Elbasan, Tiranë, Sarandë, Gjirokastrë, Ersekë, Guri i Kuq, Durrës,



Vlorë dhe Berat. Shërbimi brenda qytetit të Korçës ofrohet nga një kompani vendase. Në bashki janë të regjistruar 60 persona fizik për shërbim transporti me mikrobuzë dhe 90 me taksi. Dy kompani transporti, ajo Skënderbeu dhe Andeisa, ofrojnë transport vajtje - ardhje me autobus për në Greqi, ndërsa agjencia turistike Egnacia Tours ofron udhëtime dhe pushime në Turqi, Kroaci, Maqedoni, Francë dhe Itali.

Transport and Communications



Korça's location means that there are four international airports and two sea-ports less than a four hour drive away.

Roads

Korça has a unique structure and feel. The city has wide asphalted boulevards with pedestrian areas and kerbs paved with stone. The streets

in the traditional architecture quarters, paved with black stone from Morava Mountain, are well maintained and create a special ambience to the city compared with most Albanian cities. During the last decade the municipality has begun to revitalise Korça. In 2006, it aimed to systematise and asphalt some 20,000 m² of roads and renovate 8,000 m² of flagstone pavements.

Compared to other areas in Albania, Korça has a good quality road network. Moreover, investments are being made to improve the roads that connect it to the west of the country, with the capital city Tirana and the sea-port city of Durrës, along international Corridor VIII, which connects the Black Sea port of Burgas with the Adriatic Sea.

Transport

Bus transport to other cities and towns in Albania is provided by private companies and there are regular services to the cities of Elbasan, Tirana, Saranda, Gjirokastra, Erseka, Guri i Kuq, Durrës, Vlorë and Berat. There is one local bus company providing a service within Korça, and there are 60 minibuses and 90 taxis registered with the municipality. Two companies (*Skenderbeu* and *Andeisa*) provide a bus service to and from Greece, while a tourist agency (*Egnacia Tours*) offers trips and holidays to Turkey, Croatia, Macedonia, France and Italy.

Distance from other cities in the Balkans

City	Distance (km)
Tirana (airport)	180
Durrës (port)	200
Thessalonica (port & airport)	250
Shkodra	268
Skopje (airport)	287
Prishtina (airport)	310



Ekonomi e Korçës mbështet kryesisht në industrinë lehtë, ndërtim, tregti dhe shërbime, sektorë të cilët janë dhe punësuesit më të mëdhenj vendorë. Turizmi ka filluar të konsolidohet, kryesisht duke shfrytëzuar ambientet dhe objektet kulturore, si dhe bukuritë natyrore të zonave përreth. Rehabilitimi i rrugëve që lidhin pikat e afërta kufitare me Greqinë dhe Maqedoninë ka lehtësuar lidhjen e Korçës me hapësirat ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare përgjatë Korridorit VIII.

Biznesi i Korçës ka një mundësi të vërtetë t'u bërë aktiv në tregun kombëtar dhe atë ndër-rajonal ballkanik.

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) me vendet e tjera të Ballkanit do t'i përmirësojnë klimën ekonomike pasi bizneset po përgatiten të përmbushin nevojat që të konkurrojnë me vendet fqinje. Për momentin, MTL-të janë ratifikuar me Bullgarinë, Kroacinë, Maqedoninë, Serbinë, Rumaninë, Bosnjën dhe Hercegovinën, dhe Moldavinë.

Ndërtimi

Në Korçë operojnë aktualisht 28 kompani ndërtimi disa prej të cilave kanë ngritur struktura të mirë-organizuara e që po zhvillojnë marrëdhënie biznesi me kompanitë ndërkombëtare. Kjo industri është mjaft dinamike dhe ka një potencial të madh për rritje të mëtejshme duke marrë parasysh edhe nevojën në rritje për ambiente biznesi dhe strehimi, si dhe ndërtim dhe rehabilitim të infrastrukturës publike.

Veshmbathja

Ky sektor përbën rreth 31 për qind të ekonomisë së Korçës. Tradicionalisht industria është dominuar nga trikotazhi dhe prodhimi i qilimave dhe tani ka numrin më të madh të ndërmarrjeve dhe të punësuarve (midis 4.500 dhe 5.000, kryesisht gra). Ndërmarrjet më të shumta janë me sipërmarrje të përbashkëta me biznese greke. Aktualisht lënda e parë për prodhimin e artikujve kryesisht importohet. Në tregun vendor ka një potencial shumë të madh për zgjerimin e këtij sektori prodhimi.

Agrobiznesi

Korça është aktualisht epiqendër e industrisë përpunuese të prodhimeve bujqësore që ofrohen nga zona përreth qytetit dhe ka aktualisht një nga grupet më të mëdha të bizneseve të përpunimit ushqimor në vend për prodhimin e miellit, sheqerit, mishit, sallameve, prodhimeve të bulmetit dhe pijeve, si edhe përpunimit të kërmijve.

Perspektivat e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla të agrobiznesit janë të mëdha si rrjedhojë e madhësisë dhe rëndësisë së sektorit bujqësor në Rrethin e Korçës. Korça zë vendin e dytë në vend për sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore, që e bën kështu aktualisht bujqësinë sektorin më të rëndësishëm të ekonomisë së vet, e cila zë 32 për qind të ardhurave të përgjithshme. Pllaja mbi të cilën qëndron qyteti është shumë pjellore dhe është një nga zonat kryesore në Shqipëri për rritjen e grurit. Një avantazh i madh i zonës është përqindja e lartë e produkte të rritura në mënyrë organike. Rritja e numrit të bizneseve të këtij sektori është një nga prioritetet e shprehura në strategjinë e zhvillimit ekonomik të Bashkisë.

Economy

The economy of Korça is based mostly upon light industry, trade and services, which provide most of the employment. Tourism is being consolidated thanks to the cultural and historic amenities and facilities, as well as the natural beauty of the surrounding areas. Renovation of the road linking the nearby border crossings with Greece and Macedonia, have facilitated for the region access to International Corridor VIII.

Business in Korça has a great opportunity to become active in the national and Balkan regional markets. Free-trade agreements (FTAs) with other Balkan countries will improve its prospects, and producers are preparing to meet the needs of competing with those of the neighbouring countries. For the moment FTAs have been ratified with Bulgaria, Croatia, Macedonia, Serbia, Romania, Bosnia and Herzegovina, and Moldova.

Construction

There are currently 28 construction companies operating in Korça. Some have established well-organized structures that are developing relationships with international companies. This industry is now economically dynamic and has great potential for growth. The prospects for local construction companies in tenders for future projects look good for the foreseeable future.

Clothing

This sector makes up about 31 per cent of Korça's economy. Traditionally the industry has been dominated by knitwear and rugs, but now it has the largest number of enterprises and employees (between 4,500 and 5,000, mainly women) in the economy. Most enterprises are joint ventures with Greek businesses. Usually, the raw material is imported for manufacture of the finished article. There is great potential for this sector in the local market.

Agribusiness

Korça is the industrial centre for processing of local agricultural produce. It currently has one of the largest clusters of food processing businesses in the country, producing flour, sugar, meats, salamis, dairy produce and drinks, as well as processing snails.

As a consequence of the relative size and importance of Korça's agricultural sector, the prospects for its agribusiness SMEs are high. Korça has the second largest surface area of agricultural land in the country, making agriculture currently the most important sector in its economy, accounting for 32 per cent of total revenues. The plateau on which the city stands is highly fertile and is one of Albania's main wheat-growing areas. Of great advantage to the industry in this area is the high percentage of organically grown produce. Increase in the number of businesses in this sector is one of the priorities in the Korça Local Economic Development Strategy.





Potencialët për zhvillimin e turizmit në Korçë dhe rrethinat e saj janë shumë të mëdha për shkak të pasurive historike, kulturore dhe natyrore. Mijëvjeçarët e historisë dhe kulturës kanë krijuar një vend tërheqës dhe interesant për t'u vizituar. Korça përmendet si një kështjellë që në vitin 1280 dhe në vitin 1431 ajo përmendet në dokumente si një kala e banuar. Mbas vitit 1484 qyteti i Korçës filloi të zgjerohej dhe zhvillohej me tiparet e një qendre urbane dhe qendër e zonës.

Qyteti ka qenë pjesë e shkëmbimeve kulturore dhe tregtare me perandorinë bizantine dhe me civilizimin Grek. Qyteti është banuar që në kohët e hershme, mbetjet neolitike tregojnë popullimin e qytetit 6.000 vjet më parë.

Përveç gjetjeve të veta arkeologjike, Korça është e njohur në Ballkan për mundësinë e përdorimit të natyrës, veçanërisht në zonat përreth, duke e bërë atë një vend të shkëlqyer për ekskursionistët, dashamirët e natyrës, botanistët dhe zoologët.

Në perëndim të Korçës ndodhet qyteza e Voskopojës, një vend tërheqës për turistët, sepse është streha e shumë kishave dhe manastireve bizantine. Në fshatin e Mborjes (3 km larg Korçës) ndodhet një nga kishat më të vjetra në vend që daton vitin 1390, por që është ngritur mbi rrënojat e një kishe akoma më të vjetër që daton në shekullin IV. Dy fshatra të tjerë të afërt, Kamenica dhe Barçi strehojnë gjetje të ndryshme arkeologjike që përfshijnë edhe tumuli (kodërvarret) që datojnë në Epokën e Bronzit. Fshatrat e afërt si Boboshtica ofrojnë varietete vendase të rrushit e frutave të tjera, që përdoret për prodhimin e verës dhe rakisë (rakia e manit është një shembull i shkëlqyer).

Sasia dhe cilësia e ambienteve dhe kapaciteteve akomoduese në Korçë është përmirësuar dukshëm vitet e fundit. Agjencitë e udhëtimeve dhe ato turistike janë tashme aktive dhe mbulojnë mjaft shërbime për vizitorët dhe turistët.

Tourism

The potential for tourism development in Korça and the surrounding area is very high thanks to its historical, cultural and natural wealth. Millennia of history and culture have created a very attractive and interesting location to visit, as well as to live in. Korça is mentioned as a castle in 1280 and, in 1431, as an inhabited castle. After 1484, the city started to expand and develop gaining the features of an urban and regional centre.

The city has participated historically in intensive exchange of culture and trade with Byzantium and Greece. Neolithic remains indicate the successive occupation of the city area for the last 6,000 years.

As well as its archaeological remains, Korça is famous in the Balkans for ease of access to nature, making it an excellent destination for hikers, nature enthusiasts, botanists and zoologists.

To the west of Korça lies the town of Voskopoja, an outstanding site for tourists as it is home to many Byzantine churches and monasteries. The village of Mborja (3 km from Korça) has one of the oldest churches in the country, dating to 1390, but built on the ruins of an even older church dating back to the IVth century. Two other nearby villages, Kamenica and Barç, are the sites of various archaeological finds, including tumuli that date back to the Bronze Age. Nearby villages such as Boboshtica offer local grape and other fruit varieties that produce rare, excellent wines and rakis (mulberry raki being one fine example).

The number and quality of accommodation facilities on offer in Korça has improved notably in recent years. Travel and tourist agencies are active locally and provide a range of quality services for inhabitants and visitors alike.



Korça ofron një mundësi tërheqëse dhe shumë konkurruese për zhvillimin e biznesit, të mbështetur nga Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Korçës e cila ofron shërbime në ndihmë të fillimit, funksionimit dhe konsolidimit të bizneseve. Aktualisht në Korçë ushtrojnë veprimtarinë e tyre 81 kompani të huaja.

Biznese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Korçë

Bizneset e mëdha

Aktiviteti	Numri
Tregti	106
Prodhim	79
Shërbime	31
Ndërtim	28
Hotele	3
Bingo	1
Supermarket	1
Gjithsej	249

Bizneset e vogla

Aktiviteti	Numri
Industriale	422
Shërbime	243
Ushqim / Ushqimore	236
Transport	203
Bar-bufe	201
Ambulant	163
Prodhim	107
Shërbime mjekësore	57
Mish	32
Bilardo dhe lojëra	30
Hotel	9
Peshk	6
Sociale & kulturore	6
Fruta & perime	4
Gjithsej	1.719

Fuqia punëtore

Burimi më i rëndësishëm i punësimit në Korçë janë banorët e zonës, e veçanërisht të rinjtë. Për këtë arsye arsimimi dhe kualifikimi, për t'ju përshtatur nevoja të tregut, përbën një prioritet të Bashkisë së Korçës. Fëmijët arsimohen në një sërë shkollash private dhe publike në qytet, ndërsa arsimi i mëtejshëm universitar ofrohet nga Universiteti Fan Noli i Korçës. Çdo vit, shumë studentë diplomohen në një gamë të gjerë degësh, kryesisht në ekonomik (financë, turizëm, menaxhim biznesi, marketing) dhe agrobiznes (hortikulture, agro-ushqim, agrobiznes), mësuesi (cikël parashkollor dhe i ulët, gjuhë angleze, matematikë, sociologji), si dhe infermieri.

Viti 2006 shënoi një rritje të sasisë dhe cilësisë shërbimeve të punësimit, si dhe kompjuterizimin e informacionit rreth punëdhënësve, punë-kërkuesve dhe vendeve të lira të punës. Aktualisht funksionon një sistem i trajnimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut, kryesisht për profesionet rrobaqepësi, hidraulik, elektrik, kozmetikë, qepje këpucësh etj. Për vitin në vazhdim janë parashikuar të kryhen nga Zyra Rajonale e Punësimit 300 vizita në subjektet punëdhënëse që synojnë të zgjerojnë aktivitetin e tyre, në mënyrë që të intensifikohen kontaktet me sektorin privat dhe të grumbullohet e sistemohet informacion për vendet e punës që mund të hapen.

Punëkërkues në qytet për vitin 2005

Gjithsej	Femra	Mosha (vite)				Niveli i arsimimit të përfutur			
		16-24	25-34	35-45	> 45	Parësor	Dytësor	Profesional	Universitet
5.421	3.033	1.324	1.412	1.311	1.374	3.510	1.369	420	122

Korça offers an attractive and very competitive opportunity for the development of business, supported by the local Chamber of Commerce and Industry, which provides information on starting, running and consolidating a business. There are 81 foreign companies currently operating in Korça.

Numbers of different types of businesses operating in Korça

Large businesses

Activity	Number
Trade	106
Production	79
Services	31
Construction	28
Hotels	3
Bingo	1
Supermarket	1
Total	249

Small businesses

Activity	Number
Industrial	422
Services	243
Food	236
Transport	203
Bar-buffet	201
Ambulant	163
Production	107
Medical services	57
Meat	32
Billiards and games	30
Hotel	9
Fish	6
Social & cultural	6
Fruit & vegetables	4
Total	1,719

Workforce

Korça's most important resource is the people of the area, particularly the youth. Thus education to fit the market needs is a priority for the municipality. Children are educated at the many local schools, with further education provided by Korça's Fan Noli University. Every year, many university students graduate in a range of subjects, primarily focused on economics (finance, tourism, business management, marketing) and agribusiness (horticulture, agriculture, food industry), as well as on teaching (pre-school and elementary school teaching, in English language, mathematics, sociology), and nursing.

The year 2006 saw an increase in the quantity and quality of employment services, as well as computerisation of information on employers, unemployed and vacancies. Moreover, a professional training system has been introduced in accordance with the market needs; typically for tailors, plumbers, electricians, beauticians, cobblers, etc. For this year, in order to intensify contacts with the private sector and to collect and systemise information on anticipated job vacancies, the Regional Labour Office has planned to undertake some 300 visits to enterprises aiming to enlarge their activity.

Number of unemployed in city, 2005

Total	Female	Age (years)				Level of education received			
		16-24	25-34	35-45	> 45	Primary	Secondary	Professional	University
5,421	3,033	1,324	1,412	1,311	1,374	3,510	1,369	420	122



Energjia elektrike

Furnizimi me energji elektrike për Korçën ofrohet nga kompania shtetërore KESH. Sistemi i furnizimit është rehabilituar tërësisht në vitet e fundit, duke përfshirë nën stacionin elektrik të qytetit, i cili ka një fuqi të instaluar prej 42 MW. Sistemi i transmetimit të tensionit të mesëm 20 KW është tashmë i rikonstruktuar dhe tensioni i ofruar është i qëndrueshëm.

Telekomunikacioni

Telefonia me linjë fikse ofrohet nga ofruesi kombëtar Albtelekom, që ofron edhe shërbimin e internetit. Shërbimi i telefonisë lëvizëse (celulare) ofrohet, ashtu si në të gjithë vendin, nga kompanitë Vodafone dhe AMC. Ka edhe ofrues shërbimi të tjerë vendas duke përfshirë këtu shërbimin e telefonisë me kartë.

Furnizimit me Ujë të Pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm në Korçë, ku përfshihen stacionet e reja të pompimit të ujit, janë rinovuar kryesisht me ndihmën e Qeverisë Gjermane. Uji i pijshëm i kalon standardet e BE dhe qyteti është i pari në vend që ka furnizim të vazhdueshëm 24 orë.

Pastrimi dhe Sistemet e Kanalizimeve

Bashkia, me anë të kompanisë *Korsel* ka ndërmarrë fshirjen dhe pastrimin e rrugëve, si edhe grumbullimin dhe pastrimin e borës. Çdo ditë kompania pastron rreth 74 ton mbetje të familjeve dhe 40 ton nga kompanitë private dhe bizneset e vogla. Vend-depozitimi i mbetjeve është rreth 5 ha. Së fundi, ka filluar të zbatohet një projekt që prezanton një kompleks modern për menaxhimin e mbetjeve të Korçës.

Sistemet e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe sistemet e kanaleve kulluese të ujit në Korçë janë rinovuar kryesisht me ndihmën e Qeverisë Gjermane. Vënia në funksion e sistemeve të kanaleve kulluese dhe të ujërave të zeza lehtësohet nga pjerrësia natyrore e rrugëve të qytetit.

Shërbimi i gjelbërimit

Ndërmarrja e Shërbimit Publik, që mbështetet nga dy fidanishte, mirëmban zonat e gjelbëruara të qytetit që përfshijnë 181.897 m² parqe, 3.898 m² pemë, 3.432 m² lule, 2.425 shkurre dekorative dhe 1.790 m² gardhe. Ka 265 stola dekorativë dhe 37.876 m² sheshe në qytet, duke krijuar kështu një mjedis të këndshëm për banorët.

Ndriçimi rrugor

Ndërmarrja e Shërbimit Publik mirëmban ndriçimin rrugor, që përfshin edhe lagjet e reja, të financuara nga tarifa përkatëse për këtë shërbim. Ndërmarrja gjithashtu ofron ndriçimin e qytetit në raste festash.

Public Services and Utilities

Electricity

Korça's electricity supply is provided by the national provider KESH and has been completely rehabilitated over the last couple of years, including reconstruction of the main transformer at the city's power station, which has an installed power of 42 MW. The mid-voltage 20 kV transmission system is now rehabilitated and the voltage provided is stable.

Telecommunications

Fixed line telephony is provided by the national supplier AlbTelekom, which also provides an internet service. Mobile phone service is provided, as throughout the country, by the companies Vodafone and AMC. There are also other local service providers including the Card Phone service.

Water Supply System

Overhaul of the water supply system in Korça, including new water pumping stations, has been undertaken recently with the help of the German government. The mains water passes EU standards for drinking, and the city is the first in the country to have a continuous 24 hour supply.

City Cleaning and Drainage Systems

The Municipality, through the company *Korsel Kondor*, undertakes road sweeping and cleaning, waste collection, processing and disposal, and snow clearance. Every day the company clears out nearly 74 tons of family rubbish and 40 tons from private companies and small businesses. The waste deposit site is about 5 ha in size, and a project is now beginning to introduce a modern waste management facility for the region based in Korça.

Renovation of the drainage and sewage systems in Korça has been undertaken recently with the help of the German government. Functioning of the drains and sewers is facilitated by the natural slope of the city's streets.

Greenery service

The Public Service Enterprise, supported by two nurseries, maintains the green areas of the city including 181,897 m² of parks, 3,898 m² of trees, 3,432 m² of flowers, 2,425 decorative bushes and 1,790 m² of hedges. There are 265 decorative benches and 37,876 m² of squares in the city, creating a pleasant environment for residents and visitors.

Street lighting

The Public Service Enterprise maintains street lighting, including in the new housing estates, financed by a service tax. The enterprise also provides city festival illuminations.



Taksat dhe Tarifat



Të ardhurat e bashkisë për vitin 2006

Burimi	Shuma	
	Lekë	Euro
Taksat & tarifat	130.000.000	1.040.000
Të patatueshme	16.105.000	128.840
Të tjera	148.205.000	1.185.640

Taksat dhe tarifat vjetore (ose e specifikuar ndryshe) që aplikohet nga bashkia për bizneset dhe banorët e Korçës

Tarifa	Shuma vjetore	
	Lekë	Euro
Regjistrimi i biznesit	2.500–20.000	20–160
Pastrimi	600–60.000	4,8–480
Tarifa e reklamës	10.000–20.000 m ²	80–160 m ²
Regjistrimi i banesës	1.000	8
Tarifë parkimi	1.500–15.000	12–120
Taksa e therjes	200–500 / kokë	1,6–4 / kokë
Çertifikimi i mallrave të import-eksportit	1.000–5.000	8–40
Import-eksport transport	1.000	8
Për tavolina bar-restoranti të vendosura jashtë	50 / ditë	0,4 / ditë
Muret e rrethues të ndërtesave të reja	20 m ²	0,16 m ²
Përdorimi i hapësirës publike	150–250 m ² / muaj	1,2–2 m ² / muaj
Taksë gjelbërimi	100–2.000	0,8–16
Gentplani	3.000	24
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	2 %	2 %
Taksa e tabelës	500–5.000	4–40
Taksa për zënien e hapësirave publike	30–60 m ² / ditë	0,24–0,48 m ² / ditë
Taksa për ndërtesën	8,4 m ²	0,07 m ²
Ndriçimi	200–5.000	13–40

Shuma për zë ndryshon nëse subjekti është familje apo biznes dhe nëse është objekt i TVSH.

Taxes and Tariffs

Municipal income for 2006

Source	Amount	
	Lekë	Euro
Taxes & tariffs	130,000,000	1,040,000
Non-tax charges	16,105,000	128,840
Others	148,205,000	1,185,640



Annual (or otherwise specified) charges, taxes and tariffs applied by the municipality for Korça businesses and residents

Tariff	Annual amount	
	Lekë	Euro
Registering business	2,500–20,000	20–160
Cleaning	600–60,000	4.8–480
Advertising	10,000–20,000 m ²	80–160 m ²
Registering residence	1,000	8
Parking	1,500–15,000	12–120
Livestock butchery	200–500 / head	1.6–4 / head
Import–export certification	1,000–5,000	8–40
Import–export traffic	1,000	8
Bar or restaurant, outside table	50 / day	0.4 / day
Outside walls of new buildings	20 m ²	0.16 m ²
Use of public space	150–250 m ² / month	1.2–2 m ² / month
Greening charge	100–2,000	0.8–16
Site map	3,000	24
Construction impact tax	2 %	2 %
Label tax	500–5,000	4–40
Occupying public space	30–60 m ² / day	0.24–0.48 m ² / day
Residences	8.4 m ²	0.07 m ²
Lighting	200–5,000	13–40

The amount per item varies according to whether the subject is a family or a business, and whether it is subject to VAT.



Korça ka qenë ndër shekuj një qendër e rëndësishme arsimore, kulturore, artistike dhe fetare. Shkolla e parë për mësimin në gjuhën shqipe u ngrit në qytet më 1887, dhe tani është muze, e ndjekur nga shkolla e parë shqiptare për vajza më 1891. Në muze ndodhen disa dokumente të rëndësishme kombëtare siç janë dy librat e parë të abetares në shqip shkruar përkatësisht nga Naum Veqilharxhi dhe Kostandin Kristoforidhi.

Korça është një shembull i mirë i bashkëjetese në harmoni të krishterëve ortodoksë dhe besimtarët myslimanët. Në qytet ndodhet selia e peshkopit metropolit ortodoks të zonës edhe ka gjithashtu një xhami të madhe të shekullit 15. Ndërtesa dhe institucione të tjera të rëndësishme fetare përfshijnë katedralen “Ringjallja e Krishtit”, mitropolinë “Burimi Jetëdhënës”, kishat e Shën Ilias, Shën e Premtes, Trininë e Shenjtë, Shën Athanasit dhe Shën Anës, dhe xhaminë e re.

Muzeumet janë një tjetër dëshmi e historisë dhe traditës së pasur të qytetit si ai i Vangjush Mios (piktur 1897–1957), i Kombëtar i Artit Mesjetar (me një koleksion prej 7.000 vepra arti), i Arkeologjisë, i Arsimit dhe Artit Oriental Bratko.

Me interes të veçantë paraqiten artefaktet e gjetura në muzeun arkeologjik, disa nga të cilat datojnë në Epokën e hershme të Hekurit, kurse të tjerat vijnë nga periudhat helenike, romake dhe bizantine.



Korça ka një traditë të gjatë në muzikë. Tefta Tashko Koço ishte një këngëtare e njohur vendase që pati një karrierë ndërkombëtare. Qyteti është i njohur gjithashtu edhe si qendra e korit “Lira” që u ngrit më 1922, si edhe ansambli “Vangjush Mio” një trupë e suksesshme folklorike. Ai ka gjithashtu edhe një bandë frymore që daton më 1907.



Korça ka disa lagje të vjetra me shtëpi dhe rrugë karakteristike, ku gjendet edhe kinema “Millennium”, e cila ndodhet në ndërtesën që fillimisht u hap si kinema “Magjestik” më 1908, kinemaja më vjetër në Shqipëri

Korça has been for centuries an important educational, cultural, artistic and religious centre. The first school to teach in the Albanian language was established in the city in 1887, and is now a museum, followed by Albania's first school for girls in 1891. The museum houses some important national documents such as the first two spelling books in Albanian written by Naum Veqilharxhi and by Kostandin Kristoforidhi.



a collection of 7,000 works) and that of Vangjush Mio (painter, 1897-1957), of Archaeology and of Education as well as the Bratko Museum of Oriental Art.

Of particular interest are the artefacts housed in the Archaeology museum, some of which date back to the early Iron Age, with others from the Hellenic, Roman and Byzantine periods.

Korça has a long tradition in music. Tefta Tashko Koço was a famous local singer who followed an international career. The city is also home to the Lyra Choir, which was established in 1922, and the Vangjush Mio ensemble, a successful folk troupe. It also has its a marching band that dates back to 1907.



Korça is an excellent example of coexistence between Christianity and Islam. The city is the seat of the orthodox bishopric and has a mosque dating to the 15th century. Other important buildings and institutions include the Resurrection of Christ cathedral, the churches Life giving Source, St. Elia, St. Premte, Holy Trinity, St. Athanas and St. Ana, and a new mosque.

The city's museums exhibit its rich historical and cultural wealth, and include the National Museum of Medieval Art (with



Korça has several ancient quarters, with characteristic houses and roads, and is home to the local Millennium Cinema, which is housed in a building first opened as the Majestic Cinema in 1908, the oldest cinema in Albania.

Cilësia e Jetës

Në Korçë cilësia e jetës është mjaft e kënaqshme dhe kjo falë bukurive natyrore të zonës, kulturës dhe historisë së saj, cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës.

Rritja e dukshme e cilësisë dhe sasisë së shërbimeve dhe produkteve të ofruara nga biznesi privat po ndikon dukshëm në krijimin e një ambienti cilësisht të jetueshëm në Korçë.

E vendosur në rrëzë të maleve të Moravës dhe pranë lumenjve dhe liqeneve Korça i mundëson banorëve dhe vizitorëve një mundësi të shkëlqyer për aktivitete dhe argëtime në natyrë siç janë peshkimi dhe shëtitjet dhe veçanërisht ushtrimi i sportit të skive në kompleksin natyror të Voskopojës.

Prania në Korçë e qendrave më të mëdha shëndetësore spitalore dhe institucioneve arsimore të qarkut e forcon aftësinë e qytetit për të ofruar cilësi të lartë jetese. Qyteti ka rreth 14 kopshte, 26 shkolla fillore dhe të mesme, universitetin publik, institucion ky i rëndësishëm për qarkun dhe vendin, bibliotekë publike.

Kishat e bukura dhe ndërtesa të vjetra të qytetit, së bashku me parqet e shumta të tij, krijojnë një mjedis të këndshëm për të jetuar. Përveç ambienteve të artit e kulturës si Teatri, Kinemaja, Qendra Kulturore, Biblioteka Publike e muzeumet qyteti ofron shumë restorante, bare, si dhe ambiente të tjera dëfrimi e argëtimi për jetën e natës si disko dhe fusha për aktivitete sportive e palestra.

Jeta artistike dhe kulturore është e pasur në Korçë me aktivitete ku ftohen artistë të vendit dhe të huaj. Çdo vit Bashkia organizon “Ballkan 2000” (komedi të trupave të ndryshme të Ballkanit dhe Evropës), Serenata Korçare (konkurs për këngët qytetare Korçare), Karnavalet dhe Ballon me Maska. Tre TVtë dhe radiot lokale shpërndajnë dhe promovojnë cilësisht aktivitetet në qytet.



Quality of Life



There are certain aspects of life in Korça that create an excellent quality of life, and these include ease of access to the area's scenic beauty, its history and culture, the quality of public services and infrastructure.

The notable increase in the quality and quantity of products and services provided by Korça's private businesses improve further this quality of life.

The city's location at the foot of Morava Mountain and near to rivers and lakes creates an excellent opportunity to enjoy the outdoors, for fishing and walking, and, in winter, skiing at the outdoor sports facility at Voskopoja.

The presence in Korça of the region's main health centres, hospitals and educational institutions strengthens the quality of life. The city has some 14 kindergartens, 26 primary and secondary schools and a university, an important institution for the region and the country.

Korça has many beautiful churches and old buildings, and, together with its numerous parks, these create a pleasant environment in which to live. Besides the public cultural and art facilities, the theatre, cinema, cultural centre, library and museums, the city has many restaurants, bars and discos, as well as sports facilities, including gyms.

The artistic and cultural life in Korça is rich, with activities hosted to which artists from Albania and elsewhere come. Each year the Municipality holds 'Balkan 2000' (a comedy festival with acts from other Balkan and European countries), Korça Serenade (local folk song festival), a Carnival and Masked Ball. Three local TV and radio stations broadcast and promote the events held in the city

Financimi dhe Stimujt Financiarë për Bizneset



Bankat vendase ofrojnë shumë ndihmë për funksionimin dhe zhvillimin e biznesit dhe ekonomisë vendase të Korçës. Sistemi bankar është i sigurtë dhe ofron kredi afatshkurtra dhe afatgjata, si edhe procedura të thjeshta për të hapur llogari dhe për të transferuar fonde. Konsolidimi i qëndrueshmërisë politike si në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit, e ka reduktuar nivelin e riskut, që ndikon në uljen e normave të interesit. Në dispozicion janë edhe një numër shërbimesh elektronike 24 orësh.

Bankat që kanë degët e tyre në Korçë janë: Banka Kombëtare Tregtare, Banka Raiffeisen, Banka Amerikane e Shqipërisë, Banka e Tiranës, Banka Kombëtare e Greqisë, Banka ProCredit, Alpha Bank dhe Credins Bank.

Ka disa shoqëri të tjera private të vendosura në qytet të specializuara në ofrimin e mikrokredive për biznesin e vogël. Ato operojnë me tarifa dhe norma interesi konkurruese. Në qytet janë vendosur edhe kompani të ndryshme sigurimi të cilat ofrojnë një shërbim të shpejtë dhe efektiv. Western Union ka një degë lokale në qytet.

Depozitimet e banorëve të Korçës arrijnë në 100 milionë dollarë amerikanë. Këto janë para që mund të investohen në zonë nga bankat. Pasurimi i shërbimeve bankare si për individët ashtu dhe për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, është një proces i vazhdueshëm dhe që po zhvillohet vazhdimisht.

Programet e Zhvillimit

Shumë aspekte të tjera që ndikojnë në cilësinë e jetës së banorëve të zonës janë përmirësuar duke përfshirë zhvillimet e bëra për funksionimin e demokracisë, industrisë, biznesit, infrastrukturës dhe shërbimeve. Në përpjekjet e veta bashkia është ndihmuar shumë nga programe të ndryshme zhvillimi, kryesisht ndërkombëtare.

Korça është e njohur si një Bashki ku projektet ndërkombëtare kanë sukses dhe rezultate të qëndrueshme. Donatorët dhe partnerët e huaj më kryesorë që i kanë kontribuar zhvillimit të Korçës janë: Qeveria Gjermane, nëpërmjet GTZ dhe Bankës KfW, Grupi i Bankës Botërore, SIDA, USAID, Kooperacioni Zviceran, Qeveria Holandeze, OSFA/SOROS, REC, FShZh (Fondi Shqiptar i Zhvillimit).

Në Bashkinë e Korçës operojnë rreth 59 organizata dhe shoqata me të cilat Bashkia bashkëpunon vazhdimisht në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit.

Plani Strategjik për Zhvillimin Ekonomik Vendor i Korçës, i hartuar me mbështetjen e Grupit i Bankës Botërore, LGI/SOROS e FLAG dhe miratuar në 2005, po mundëson një koordinim dhe bashkërendim më efektiv të aktorëve vendorë dhe të huaj të përfshirë në programet dhe projekte zhvillimore për Korçën.

Funding

Funding Opportunities and Business Incentives

Local banks provide much assistance to the performance and development of Korça business and the local economy. The banking system is secure and offers short- and long-term loans, and simple procedures to open accounts and transfer funds. The consolidation of political stability in both Albania and the Balkan region has reduced both the level of risk and interest rates. A number of 24-hour electronic services are available.

The following banks have branches in Korça: National Commercial Bank, Raiffeisen Bank, American Bank of Albania, Tirana Bank, National Bank of Greece, ProCredit Bank, Alpha Bank and Credins Bank.

Some private associations are based in the city and these are specialized in providing micro-credits to small business. They have competitive charges and interest rates. There are also various insurance companies and these operate a fast and effective service, and Western Union has a local branch.

Deposits made by Korça's inhabitants amount to 100 million USD, and this is money that can be invested locally by the banks. Introduction of fuller banking services to both individuals and businesses, particularly to SMEs, is an on-going process and one that is constantly being developed.

Development Programmes

Many other factors that affect the quality of life of local residents have also been improved, including developments made to the functioning of democracy, industry, infrastructure and service provision. In its endeavours the municipality has been greatly assisted by various, mainly international, development programmes.

There are currently operating in the city 59 organizations and associations with which the municipality is cooperating in the development and implementation of strategies and action plans.

Korça has a well-known record of success, with sustainable results, with international programmes. The major international donors and programmes contributing to the development of the city are the German Government (through KfW and GTZ), World Bank Group, SIDA, USAID, Swiss Cooperation, Government of the Netherlands, OSFA/SOROS, REC, ADF (Albanian Development Fund).

The Strategic Plan for Local Economic Development for Korça, developed with the support and assistance of the World Bank Group, LGI/SOROS and FLAG and adopted in 2005, has created effective coordination and cooperation among the local and international stakeholders.





Ky profil biznesi është hartuar nga Bashkia e Korçës në kuadër të projektit DELTA (Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave) dhe me këshillimin dhe asistencën teknike të Grupit të Bankës Botërore, LGI (Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike, pjesë e Institutit Shoqëria e Hapur e Fondacionit Soros, Hungari) dhe FLAG (Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje). Te dhënat dhe informacionet e prezantuara në këtë profil janë përgatitur dhe ofruar nga Bashkia e Korçës.

*Foto të ditëve të sotme nga Xhimi
Harta © Encarta 2006*



E drejta e autorit © 2006 Bashkia e Korçës

*Kopje të këtij Profili dhe të Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik të Korçës
mund të shkarkohen në adresën e mëposhtme të Internetit:
http://lgi.osi.hu/documents.php?m_id=109*



This business profile has been written by the Municipality of Korça as part of the project DELTA (Developing Economies Locally through Techniques and Alliances) and with advice and technical assistance from the World Bank Group, LGI (Local Government and Public Services Reform Initiative, part of the Open Society Institute of the SOROS Foundation), and FLAG (Foundation for Local Autonomy and Governance). The data and information presented in this profile are prepared and provided by the Municipality of Korça.

Contemporary photos by Xhimi

Map © Encarta 2006



Copyright © 2006 Municipality of Korça

Copies of this Profile and the Strategic Plan for Economic Development of Korça can be downloaded by following the link at:

http://lgi.osi.hu/documents.php?m_id=109



BASHKIA KORÇË
Rr. “28 Nëntori”
Korçë, Shqipëri

Tel: +355 82 42004
Fax: +355 82 43353